



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

DREJTORIA E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT TE MINIERAVE

Nr. 8108

Tirane, date 15/12/2015

Drejtuar: ZNJ. TANA MARGARITI
SHOQERIA "MARGARITI" SHPK
JERGUCAT

GJIROKASTER

Për njoftim: Z. DAEL DERVISHI, DREJTOR EKZEKUTIV
AGJENCIA KOMBETARE E BURIMEVE NATYRORE
BULEVARDI "BAJRAM CURRI" BLLOKU "VASIL SHANTO"

TIRANE

Z.RRAPUSH TOLA, DREJTOR
REPARTI INSPEKTIM-SHPETIMIT TE MINIERAVE
RRUGA "LORD BAJRON", LAPRAKE

TIRANE

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi te lejes nr.879 date 24.06.2005.

E nderuara znj. Margariti,

Shoqëria "Margariti" shpk është zotëruese e lejes minerare te shfrytëzimit nr.879 date 24.06.2005 për gurë gëlqeror, ne objektin "Jergucat", ne Qarkun Gjirokastër.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr. 8136 date 07.09.2015, protokolluar ne Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) me nr.6025 date 08.09.2015, është propozuar revokimi i lejes minerare te shfrytëzimit nr.879 date 24.06.2005 për gurë gëlqeror, ne objektin "Jergucat", ne Qarkun Gjirokastër, për arsye se nuk është paguar garancia financiare për rehabilitimin e Mjedisit siç është përcaktuar ne nenin 31, pika 5 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë" te ndryshuar, për vitin 2015-2016.

Leja juaj është dhëne me Ligjin nr.7796 date 17.02.1994 "Minerar te Shqipërisë" te ndryshuar qe është shfuqizuar me ligjin nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar.

Sipas nenit 57 pika 2 dhe 3 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Leja juaj është dhëne për një afat fillestar për 10 vite dhe ky afat vlefshmërie ka mbaruar me date 24.06.2015. Ne zbatim te pikës nr.6 te nenit 24 te ligjit nr.10304 date 15.07.2010 "Për sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë", te ndryshuar duhet te kishit aplikuar pranë Qendrës

Kombëtare të Licencimit, për zgjatjen e këtij afati edhe për 10 vite të tjera, 180 dite përpara përfundimit të afatit fillestar, gjë të cilën ju nuk e keni bërë.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në gërmën “ç” të pikës 1 të nenit 47 (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet) të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Sa më sipër në zbatim të nenit 48 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.879 datë 24.06.2005 për gurë gëlqeror, në objektin “Jergucat”, në Qarkun Gjirokastrë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes nr.879 datë 24.06.2005 për gurë gëlqeror, në objektin “Jergucat”, në Qarkun Gjirokastrë.

Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë” duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

